



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pzd.nr.29/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Y. (...) H., me vendbanim në rr...., në P., për shkak të veprës penale vjedhja, nga neni 313 par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, veprës penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, veprës penale vjedhja grabitqare nga neni 325 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën e të dënuarit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.02.2024, morri këtë:

### A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit Y. H. për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë, PK.nr.137/2023 të datës 13.11.2023.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin PK.nr.137/2023 e datës 13.11.2023, i ka ndryshuar aktgjykimet e plotfuqishme:

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.107/2022 e datës 12.04.2022, me të cilin i dënuari Y.H., është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja, nga neni 313 par.1 KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej ... (...) ditësh dhe dënim me gjobë në shumën prej... (...) euro;

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.765/2020 e datës 14.02.2022 me të cilin i dënuari Y. H., është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, si dhe veprën penale kanosja nga neni

181 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, i cili është obliguar që ta paguaj në afat prej... (...) ditësh, pasi aktgjykimi ta merr formën e prerë;

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.400/2020 e datës 09.12.2020, me të cilin i dënuari Y. H., është shpallur fajtor për dy vepra penale vjedhja, nga neni 313 par.1 KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej ... (...) muaj dhe dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, si dhe

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.107/2022 e datës 12.04.2022, me të cilin i dënuari Y. H., është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja grabitqare, nga neni 328 par.1 KPRK-së, si dhe veprës penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej ... (...) vite e ... (...) muaj, dhe dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro;

Gjykata e shkallës së parë duke bërë unifikimin e këtyre dënimeve të shqiptuara, konform dispozitës së nenit 420 par.1 nënpar.1.1 e par.5 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe në bazë të nenit 76 par.2 të KPRK-së, me aktgjykimin e lartëcekur të dënuarit i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej... (...) vite e ... (...) muaj, si dhe dënim unik me gjobë në shumën prej ... (...) euro, e cila gjobë do të paguhet në... (...) këste, me nga ... (...) euro, të cilat do të ekzekutohen nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka ushtruar i dënuari Y. H., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj kërkesën dhe t'ia zbutë dënimin.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KZJD.nr.29/2024 e datës 06.03.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Pejë, me shkresën PK.nr.08/2024 e datës 15.02.2024, si dhe Prokuroria Themelore në Pejë, në mendimin PP.II.nr.620/2020, PP.II.nr.625/2020, PP.II.nr.1355/2020 dhe PP.II.nr.2349/2017 e datës 05.02.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me dispozitën e nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), propozimin e bëra dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikojnë në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e tij i dënuari thekson se veprat penale për të cilat është dënuar i ka kryer nën ndikimin e drogës, i cili ka qenë i dëshpëruar shumë me jetën e tij dhe se nuk ka gjetur punë dhe nuk e ka pasur përkrahjen e familjes. Tutje thekson se është penduar për veprimet të cilat i ka ndërmarrë, se gjatë vuajtjes së dënimit është rehabilituar dhe se merret me aktivitete të cilat kanë ndikuar pozitivisht tek gjendja e tij emocionale dhe edukuese, andaj, mendon se zbutja do të ishte e nevojshme në mënyrë që të dalë sa më shpejt nga vuajtja e dënimit dhe të krijojë familje e të punojë dhe të kujdeset për familjen e tij.

Gjykata Supreme konstatoi se nga shkresat e lëndës del se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Disa prej rrethanave në të cilat thirret i dënuari në kërkesë kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykatat, kurse rrethanat tjera me të cilat thirret në kërkesën nuk janë të asaj natyre që justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit kur kihet parasysh pesha e veprave penale. Në anën tjetër vuajtja e dënimit për pasojë ka mos mundësinë e përfilljes së disa obligimeve të cilat mund të kryhen kur personi është në liri dhe është pasojë e heqjes së lirisë.

Nga sa u tha, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.29/2024, më datë 12.03.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi